

Njoftim për mosankimin e vendimit nr. 11, datë 10.4.2018, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. Ermir Beta

Në zbatim të dispozitave të nenit 179/b, pika 5, i Kushtetutës, nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, nenit 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 15 të rregullores së Institucionit të Komisionerëve Publikë, pas shqyrtimit të vendimit nr. 11, datë 10.4.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Ermir Beta, Institucioni i Komisionerëve Publikë njofton se nuk është ushtruar ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.